

Buletini mujor

30/09/2022

Oda Ekonomike e Kosovës,
Nëna Terezë, 10000 Prishtinë
www.oek-kcc.org, info@oek-kcc.org,
038 224 299

PËRMBAJTJA

1. Pasqyrë e Ekonomisë
2. Aktivitetet e Odes
Ekonomike të Kosovës

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) është organizatë profesionale e themeluar në vitin 1962 nga Kuvendi i Kosovës. Është institucion në shërbim të ekonomisë kosovare, partner konstruktiv i institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, partner në dialogun social si dhe promotor i zhvillimit ekonomik dhe politikave të mira makroekonomike.

OEK-u është organizatë profesionale, e pavarur, jopolitike dhe jo-fitimprurëse. Është përfaqësuese legjitime e interesave të komunitetit të biznesit në Kosovë. Është burim i besueshëm i informatave për ndërmarrjet kosovare si dhe për ndërlidhjen me partner ndërkombëtar, analizon gjendjen ekonomike të Kosovës dhe aktivisht propozon forma të reja dhe të avancuara të biznesit vendor dhe bën ndërkombëtarizimin e ndërmarrësisë kosovare. Ka shtrirje në të gjitha rajonet kryesore të Kosovës.

1. Pasqyrë e Ekonomisë së Kosovës


Bruto Produkti Vendor (BPV) në tremujorin e dytë (TM2) të vitit 2022 ka shënuar një rritje reale për 2.14 % ë krahasim me TM2 të vitit 2021.

Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike është si vijon: Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, transporti dhe magazinimi, aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (12.58%); Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse (8.38%); Aktivitetet financiare dhe të sigurimit (7.48%);

Informacioni dhe komunikimi (6.85%); Artet, argëtimi dhe çlodhja, aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera (5.54%); Industria nxjerrëse dhe përpunuese, energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër, furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe rehabilitimi (4.51%); Bujqësia, pyjet dhe peshkimi (1.93%); Aktivitetet e pasurive të paluajtshme (1.56%).

Ndërsa, aktivitetet ekonomike që shënuan rënie në këtë tremujor ishin: Ndërtimtaria (-17.97%); Administrata publike, sigurimi social, arsimit dhe shëndetësia (-0.64%).

Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje ishin: Eksporti i mallrave dhe shërbimeve (36.02%); Importi i mallrave dhe shërbimeve (4.57%); Shpenzimet e konsumit final (2.40%). Ndërsa, rënie kishin: Formimi i bruto kapitalit (-16.81%); dhe shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (-2.81%).



Statistikat tregtare për muajin Maj 2019

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), për për muajin gusht 2022, tregojnë për një deficit tregtar më të larët për (25.3%), në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2021, gjegjësisht në vlerë prej 441,9 milion euro krahasuar me deficitin 352,6 milion euro në vitin 2021.


Eksporti mbulon importin (16.1%).

Eksporti i mallrave në muajin gusht 2022 kishte vlerën 84,8 milion euro, ndërsa importi 526,8 milion euro, është një rritje prej (30.6%) për eksport si dhe (26.2%) për import duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2021.

Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit: (23.2%) të eksporteve e përbëjnë produktet minerale, (18.0%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (16.2%) artikuj të ndryshëm të prodhuar, (11.1%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (7.8%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (4.9%) produkte bimore, etj.



Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesor për import e përbëjnë: (22.9) produktet minerale, (12.2%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (10.5%) makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, (9.3%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (6.4%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (6.3%) produkte të industrisë kimike (6.0%) mjetet e transportit, etj.




Tregtia e jashtme e mallrave me 27 vendet e BE-së


Eksportet e Kosovës në vendet e BEsë arritën në 31,0 milion euro, ose rreth (36.5%) e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej (51.2%). Partneret kryesor për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (8.4%), Danimarka (6.2%), Sllovenia (5.9), Holanda (3.3%), etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BEsë-27 ishin rreth 213,2 milion euro, ose (40.5%) e importeve të përgjithshme, me një rritje prej (20.2%). Importet me pjesmarje me të lartë ishin nga: Gjermania (9.5%), Greqia (8.7%), Italia (3.8%), Sllovenia (3.4%), etj.

Eksportet në muajin gusht 2022 me vendet e BE-së (000 €)




Importet në muajin gusht 2022 nga vendet e BE-së (000 €)




Tregtia me vendet e CEFTA-së

Në muajin gusht 2022, eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së arritën në 32,2 milion euro, ose (38.0%) të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej (27.2%). Partner kryesor për eksport nga vendet e CEFTA-së janë: Shqipëria (14.8%), Serbia (9.2), Maqedonia (8.4%), Mali i zi (4.4%).



Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-së në muajin gusht 2022, arritën në 100,0 milion euro, ose (19.0%) të importeve të përgjithshme, me një rritje prej (26.9%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Serbia (7.4%), Maqedonia (5.5%), Shqipëria (4.1%).





Tregtia me vendet e EFTA-së

Eksporti me vendet e EFTA-së në muajin gusht 2022 arriti në vlerë prej 5.7 milion €. Vendet me pjesëmarrje më të madh në eksport ishin: Zvicra (6.5%) dhe Norvegjia (0.2%).

Importi me vendet e EFTA-së arriti në vlerë prej 4.1 milion €. Vendi me pjesëmarrje më të madhe në import ishte Zvicra (0.7%).

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 21,6 milion euro, ose (25.5%). Si partner më të rëndësishëm nga këto vendet për eksport vlen të përmendën: SHBA (11.7%).

Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 213,5 milion euro, ose (40.5%). Vendet me pjesmarje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (13.6%) dhe Kina (10.1%).




Inflacioni mujor dhe vjetor

Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte -0,2% në muajin gusht 2022 krahasuar me muajin korrik 2022. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (6.3%); qumësht, djathë dhe vezë (3.6%); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (2.3%); mish (1.7%). Ndërsa, rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (-6.1%), me një ndikim prej (-0.4 për qind) në IHÇK-it.


Ndërkaq, norma vjetore e inflacionit në muajin gusht 2022 krahasuar me muajin gusht 2021 ishte 13.0%. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te nëngrupet e COICOP-it: vajra dhe yndyra ushqimore (52.1%); lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (48.6%); bukë dhe drithëra (32.4%); karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (32.0%); qumësht, djathë dhe vezë (26.2%); gaz (26.1%); mish (22.5%); sheqer, reçel, mjaltë, çokollata dhe ëmbëlsira (19.7%); shërbime për transport (17.9%); kafe, çaj dhe kakao (17.6%); prodhime të ndryshme etj.

Ndërsa, rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet i COICOP-it: pemë (-8.2%); perime (-1.2%); veshje (-0.7%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.3 për qind) në IHÇK.

NDRYSHIMET MUJORE TË ÇMIMEVE PËR 2022



NDRYSHIMET VJETORE TË ÇMIMEVE 2021-2022



Numri i ndërmarrjeve të regjistruara gjatë TM2 - 2022

Në TM2 2022 gjithsej janë regjistruar 2 835 ndërmarrje. Krahasuar me tremujorin paraparak (TM1 2022) ka rritje për 0.1% të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraparak (TM2 2021) ka një rritje për 0.8% të ndërmarrjeve të regjistruara.

Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave, me 692 ndërmarrje të regjistruara (24.4%); Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 332 ndërmarrje të regjistruara (11.7%); Ndërtimtari me 299 ndërmarrje të regjistruara (10.5%); Prodhim me 286 ndërmarrje të regjistruara (10.1%); Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 266 ndërmarrje të regjistruara (9.4%), etj.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave, ashtu si në çdo tremujor, mbizotëron komuna e Prishtinës me 809 ndërmarrje të regjistruara (28.5%); Ferizaj me 236 ndërmarrje të regjistruara (8.3%); Prizreni me 220 ndërmarrje të regjistruara (7.8%); Gjlani me 159 ndërmarrje të regjistruara (5.6%); Peja me 156 ndërmarrje të regjistruara (5.5%); dhe Mitrovica me 129 ndërmarrje të regjistruara (4.6%).

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas prejardhjes së kapitalit TM2 2022

Kategoria e numrit të punësuarve	Gjithsej		Të huaja (degë, përfaqësi)*		Vendore	
	2,835	100%	13	100%	2,822	100%
1 deri 4	2,735	96.50%	12	92.30%	2,723	96.50%
5 deri 9	63	2.20%	1	7.70%	62	2.20%
10 deri 19	30	1.10%	-	-	30	1.10%
20 deri 249	3	0.10%	-	-	3	0.10%
250+	4	0.10%	-	-	4	0.10%

Norma efektive të interesit në bankat komerciale (për muajin korrik 2022)	
Norma në kredi[^]	6.1%
<i>për ekonomitë familjare</i>	5.9%
prej të cilave konsumuese	6.3%
prej të cilave hipotekare	4.8%
<i>për ndërmarrje</i>	6.2%
prej të cilave bujqësore	6%
prej të cilave industriale	6.3%
prej të cilave shërbyese	6.1%
Norma në depozita^{^^}	1.80%
<i>të ekonomive familjare</i>	1.6%
prej të cilave të transferueshme	0.0%
prej të cilave të kursimeve	0.1%
prej të cilave të afatizuara	1.6%
<i>të ndërmarrjeve</i>	2.0%
prej të cilave të transferueshme	0.0%
prej të cilave të kursimeve	0.2%
prej të cilave të afatizuara	2.0%
Dallimi i normës Kredi – Depozita	4.3 pp
[^] mesatare e peshuar e normave të interesit për kreditë e reja	
^{^^} mesatare e peshuar e normave të interesit në depozitat e reja	

2. Aktivitetet e OEK

Takimi me z. Keisuke Yamanaka, i Ngarkuari me Punë në Ambasadën e Japonisë në Kosovë

Kryetari Rafuna priti në takim përfaqësuesit e Ambasadës Japoneze, ku biseduan për harmonizimin e veprimeve të përbashkëta në interes të Kosovës dhe Japonisë. Kryetari Rafuna gjithashtu informoj përfaqësuesit e Ambasadës lidhur me klimën biznese në vendin tonë duke synuar tërheqjen e investimeve të huaja.



Foto nga takimi i Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm me Përfaqësues të Ambasadës Japoneze, me datë 02 gusht 2022

Takim me përfaqësuesin e Luginës së Preshevës, Shaip Kamberi



Foto nga takimi me përfaqësuesin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Shaip Kamberi.

Kryetari Rafuna është takuar me përfaqësuesin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Shaip Kamberi, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin në mes të OEK dhe bizneseve nga Lugina e Preshevës.

Z. Rafuna ka shprehur qëndrimin se bizneset nga Lugina me prezencën e tyre në Kosovë kontribuojnë në ekonominë e vendit tonë.

Kryetari Rafuna priti Ambasadorin e Shqipërisë, Qemal Minxhozi, biseduan për bashkëpunimin Kosovë-Shqipëri

Kryetari Rafuna ka takuar Ambasadorin e Shqipërisë, Qemal Minxhozi, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin ekonomik në mes dy vendeve, me theks të veçantë në mundësitë për të thelluar këtë bashkëpunim.



Foto nga takimi i Kryetarit me Ambasadorin e Shqipërisë, Qemal Minxhozi, me datë 05 gusht 2022

Kryetari Rafuna priti Ambasadoren e Izraelit, biseduan për bashkëpunimin Kosovë-Izrael

Foto nga takimi me Ambasadoren e Izraelit, Tamar Ziv

Kryetari Rafuna është takuar me Ambasadoren e Izraelit, Tamar Ziv.

Kryetari Rafuna në këtë takim shprehu qëndrimin se Kosova dhe Izraeli janë partnerët të rëndësishëm për njëri tjetrin dhe se ekonomitë e të dyja vendeve duhet të thellojnë edhe më tutje bashkëpunimin në mes tyre.

Kryetari Rafuna propozoi mbajtjen e takimeve B2B në Kosovë ndërmjet bizneseve izraelite dhe atyre kosovare.

Kryetari i Odës Ekonomike dhe Sekretari i Përgjithshëm vizituan kompaninë Al Trade



Foto nga vizita e Kryetarit në kompaninë Al Trade

Drejtuesit e Al Trade kishin kënaqësinë të mirëpresin kryetarin e ri të Odës Ekonomike, z. Lulzim Rafuna, në vizitën e tij të parë në biznese që prej marrjes së detyrës së re.

Pronari i Al Trade, së bashku me përfaqësuesit e kompanisë, e informuan në hollësi kryetarin Rafuna për projektet e përfunduara, ato në realizim e sipër si dhe ato të planifikuara për të ardhmen.

Oda Ekonomike e Kosovës nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Odën Ekonomike Kosovë-Izrael

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka nënshkruar Memorandum bashkëpunimi me Kryetarin e Odës Ekonomike Kosovë-Izrael, Robert Muharremi.

Marrëveshja parasheh bashkëpunimin e dy odave në projekte të ndryshme si dhe angazhimin e përbashkët në afrimin e bizneseve të dy vendeve.

Në ceremoninë e nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit ishin prezent edhe Skender Hyseni, Kryetar i Asamblesë së Odës Ekonomike Kosovë-Izrael, si dhe ambasadorja e Izraelit për Kosovën, Tammy Ziv.



Foto nga takimi ku u nënshkrua memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Kosovë - Izrael

Kryetari Rafuna priti Kryetaren e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare

Kryetari Rafuna priti në takim Drejtoreshen Ekzekutive të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, Nora Hasani, me të cilën biseduan për projekte të përbashkëta ekzistuese dhe të ardhshme.

Kryetari Rafuna dhe Drejtoresha Hasani u pajtuan që bashkëpunimi mes odave dhe mes bizneseve që përfaqësojnë duhet “të thellohet edhe më shumë”.



Foto nga takimi me Kryetaren e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare

Kryetari Rafuna priti Atasheun e Tregtisë dhe Ekonomisë nga Ambasada e Hungarisë në Kosovë Áron Kerékgyártó dhe përfaqësuesen e sektorit të Tregtisë në Ambasadë Mirdita Bicaj

Kryetari Rafuna me të pranishmit në këtë takim biseduan për projekte dhe një program të aktiviteteve të përbashkëta.

Kryetari Rafuna u shpreh se ambasadat kanë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e projekteve dhe lehtësimin e komunikimit në mes të odave dhe bizneseve të të dyja vendeve.



Foto nga takimi me Atasheun e Tregtisë dhe Ekonomisë nga Ambasada e Hungarisë në Kosovë Áron Kerékgyártó dhe përfaqësuesen e sektorit të Tregtisë në Ambasadë Mirdita Bicaj

Kryetari Rafuna priti drejtoreshën e Zyrës Tregtare të Odës Ekonomike te Austrisë në Prishtinë

Kryetari Rafuna ka pritur drejtoreshën e Zyrës Tregtare të Odës Ekonomike Austriake në Kosovë, Vjosa Huruglica Vranovci, me të cilën kanë biseduar për hapa konkret të bashkëpunimit në mes të dy dhomave për përkrahjen e bizneseve të dy vendeve.

Ndihma për certifikimin e prodhimeve Kosovare në standardin TUV është një nga zotimet e dala nga ky takim, si dhe zotimi për përkrahjen e investitorëve nga të dyja shtetet në realizimin e investimeve të tyre.



Këshilli Drejtues i OEK-ut

Me datën 17 gusht 2022, u mbajtë takimi i parë i Këshillit Drejtues të Odës Ekonomike të Kosovës, i kryesuar nga Kryetari i OEK-ut, njëherit edhe Kryetar i Këshillit Drejtues. Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje shumë të rëndësishme duke u nisur nga gjendja financiare e OEK-ut deri me datën 30.06.2022, pastaj diskutime konkrete pati rreth Statutit të OEK-ut. Gjithashtu, u diskutua edhe lidhur me strukturën organizative të Odës dhe antarësinë e cila është tani.

Nga gjithë ky diskutim frytedhënës dhe transparent, Këshilli Drejtues në mënyrë unanime mori vendim për krijimin e Grupit punues për hartimin e Statutit të Ri të OEK-ut, si dhe krijimin e Grupit punues për rregullimin e kuotës së antarësisë si dhe të gjitha shërbimeve që ofron Oda ndaj bizneseve.

Anëtarët e Këshillit Drejtues së bashku u zotuan se do të punojnë për reformimin e Odës Ekonomike të Kosovës, e cila do të jetë në shërbim të biznesit dhe partner konstruktiv i Institucionit të Republikës së Kosovës në të mirë të zhvillimit ekonomik të vendit.

Kryetari Rafuna priti në takim Këshilltaren e Tregtisë nga Ambasada e Republikës së Turqisë

Gjatë këtij takimi është biseduar për bashkëpunimin ndërinstytucional si dhe atë mes bizneseve të dyja vendeve.

Bashkëbiseduesit shkëmbyen ide konkrete për lehtësimin e të bërit biznes në Kosovë, duke tërhequr investimet e huaja direkte në vendin tonë si dhe për mbështetjen e bizneseve vendore për të investuar në shtetin turk.



Foto nga takimi me Këshilltaren e Tregtisë nga Ambasada e Republikës së Turqisë

Kryetari Rafuna priti Kryeshefin Ekzekutiv të Këshillit të Investitorëve Evropian në Kosovë, z. Emrush Ujkani

Kryetari Rafuna ka takuar Kryeshefin Ekzekutiv të Këshillit të Investitorëve Evropian në Kosovë, z. Emrush Ujkani, me të cilin kanë biseduar për hapa konkret të bashkëpunimit për përkrahjen e bizneseve vendore dhe investitorëve të huaj.

Bashkëbiseduesit shkëmbyen ide konkrete për lehtësimin e të bërit biznes në Kosovë, duke tërhequr investimet e huaja direkte në vendin tonë. Në takim u bisedua edhe për shqyrtimin e kërkesave të bizneseve të të dy institucioneve.



Foto nga takimi i Kryetarit Rafuna me z. Emrush Ujkani

Kryetari Rafuna priti Drejtoreshën Ekzekutive të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), znj. Ardiana Bunjaku

Kryetari Rafuna dhe Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK në këtë takim biseduan për hapa konkret të bashkëpunimit në mes të dyja palëve.

Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK znj. Bunjaku u shpreh e gatshme për t'u antarësuar në OEK dhe për të çuar përpara misionin e ngritjes së ofrimit të shërbimeve në një nivel më të lartë që do të ndikojë në zhvillimin ekonoik dhe social të vendit.

Të dy palët u pajtuan që të fillojë procedura e antarësimit të Shoqatës.



Foto nga takimi i Kryetarit Rafuna me znj. Ardiana Bunjaku

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka pritur Shefen e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë, Ambasadoren Heleni Vakali, si dhe konsullin në këtë Zyrë, Michail Verttakis

Z. Rafuna me të pranishmit në këtë takim ka biseduar për bashkëpunimin ekonomik në mes dy vendeve, me theks të veçantë në mundësitë për të thelluar këtë bashkëpunim dhe krijimin e lehtësirave për afaristët kosovarë.

Kryetari Rafuna u shpreh se Greqia është partner i rëndësishëm i Kosovës dhe se ekonomitë e të dyja vendeve duhet të thellojnë edhe më tutje bashkëpunimin në mes tyre.



Foto nga takimi i Kryetarit Rafuna me Shefen e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë, Ambasadoren Heleni Vakali, si dhe konsullin në këtë Zyrë, Michail Verttakis

Njësitë rajonale të Odës Ekonomike të Kosovës nëpër Kosovë

Njësia Rajonale Pejë:

Personi kontaktues: z. Samir Lleshi
Rr. Çarshia e gjatë -
Qendra tregtare Burma kati.2, 30000 Pejë
Tel: 045/ 560 - 999
email: samir.lleshi@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Mitrovicë:

Personi kontaktues: z. Besart Kostanica
Rr. Mbretëresha Teutë, p.n. 40010 Mitrovicë
Tel: 045/ 619 - 519
email: Besart.kostanica@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Gjilan:

Personi kontaktues: z. Ibrahim Tahiri
Rr. Abdullah Tahiri, p.n. 60000 Gjilan
Tel: 045/ 699 692
email: ibrahim.tahiri@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Ferizaj:

Personi kontaktues: z. Lulzim Azemi
Rr. Dëshmorët e Kombit, nr. 144, 70000 Ferizaj
Tel: 045/ 580 - 666
email: lulzim.azemi@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Prizren:

Personi kontaktues: z. Armend Hyseni
Rr. Remzi Ademi, nr. 27, 20000 Prizren
Tel: 049/ 709 - 657
email: armend-hyseni@hotmail.com

Referencat

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Statistikat e tregtisë së jashtme gusht 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Repertori statistikor mbi ndermarrjet ekonomike në Kosovë TM2 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit gusht 2022

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve dhe prodhimit TM2 2022

Banka Qendrore e Kosovës – Sistemi financiar korrik 2022